



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 363/ Prot.

Tiranë më 28/02 / 2022

**VENDIM**

Nr. 31, datë 24.02.2022

**PËR  
RRËZIMIN E KËRKESËS PËR MASË DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT FRANÇESK  
GANAJ, ME DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË  
RRETHIT GJYQËSOR LEZHË DHE NDAJ MAGJISTRATIT MILAN LASKAJ, ME  
DETYRË PROKUROR NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË RRETHIT  
GJYQËSOR TIRANË**

Bazuar në nenet 148/d, pika 1 dhe 149/a, pika 1, germa "b", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 102, pika 1, shkronjat "ç", "dh" dhe "l", 105, 106, 115 dhe 146, pika 2, germa "a", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në nenet 189, pika 1, germa "a" dhe 192, pika 1, të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, në nenin 104, të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë" dhe Rregulloren "Mbi funksionimin e komisionit disiplinor në zhvillimin e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve", miratuar me Vendimin nr. 260, datë 17.11.2020, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, me propozim të Komisionit Disiplinor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

**V E N D O S I:**

1. Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje publike" ndaj magjistratit Françesk Ganaj, të parashikuar nga neni 107, i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat "ç" dhe "dh", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
2. Rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për dhënien e masës disiplinore "Vërejtje publike" ndaj magjistratit Milan Laskaj, të parashikuar nga neni 107, i Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, për shkeljen disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1,



shkronja "I", të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

3. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, magistratit Françesk Ganaj dhe magistratit Milan Laskaj brenda 5 (pesë) ditëve nga data e shpalljes.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Kolegjin e Posaçëm të Apelit pranë Gjykatës Kushtetuese brenda afatit të përcaktuar nga neni 50, pika 4, të Ligjit nr. 8577, dt. 10.02.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, afat i cili fillon nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

### KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË



**KRYETAR  
GENT IBRAHIMI**

**ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA**

**ANËTAR  
SOKOL STOJANI**

**ANËTAR  
BUJAR SHESHI**

**ANËTAR  
NURIHAN SEITI**

**ANËTAR  
ELOIDA GOXHI**

**ANËTAR  
ESMERALDA KESHI**

**ANËTAR  
LUDOVIK DODA**

**ANËTAR  
ZEQIR HODA**

**ANËTAR  
SANDËR BECI**

**ANËTAR  
TARTAR BAZAJ**